# Udhëzim i shpejt
# Përdorimi i produktit

⚠ Së pari, lexo seksionin „Udhëzime për siguri“!




1. Çelësi i Ndezjes-Fikjes/Zgjedhjes së Programit
2. Treguesi i solucionit shpëlarës (☼)
3. Treguesi i paralajmërimit të nivelit të ulët të kripës (⇊)
4. Treguesi i ngarkesës përgjysmë
5. Treguesi i vonesës
6. SelfDryTreguesi
7. Drita e kontrollit të Ndezjes/Fikjes
8. Treguesi i monitorimit të programit
   a) Treguesi i larjes
   b) Treguesi i tharjes
   c) Treguesi i përfundimit të programit
9. Butoni Nis / Mbaj / Anulo
10. Butoni i funksionit të vonesës / SelfDryFunksini për 3 sekonda
11. Funksioni i ngarkesës përgjysmë / Funksioni i detergjentit tabletë për 3 sekonda
12. Treguesi i detergjentit tabletë

## Funksionet ndihmëse

Programet e larjes të lavastoviljes tuaj janë bërë për të arritur efektin më të mirë të larjes duke marrë parasysh llojin e ndotjes, shkallën e ndotjes dhe karakteristikat e enëve që do të lahen.
Funksionet ndihmëse janë bërë për t'ju dhënë mundësi të kurseni kohë, ujë dhe energji dhe për të bërë një larje sa më të rehatshme me kushtet tuaja specifike.

ℹ Funksionet ndihmëse mund të shkaktojnë ndryshime në kohëzgjatjen e programit.

## Tabela për Të dhënat e Programës dhe Vlerat Mesatare të Konsumit

| Numri i programit | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Emri i programit | Eco * | Auto | Intensive | GlassCare | Quick&Shine (#) | Mini (#) |
| Temperatura e pastrimit | 50 ℃ | 40-65 ℃ | 70 ℃ | 40 ℃ | 60 ℃ | 35 ℃ |
| Shkalla e ndotjes | I përshtatshëm për larjen e pjatave me nivel normal papastërtie. Ai është programi më efikas në kuadër të konsumit të kombinuar të energjisë dhe ujit. Kjo përdoret për vlerësimin e përputhshmërisë me direktivën e dizajnit ekologjik të BE-së. | Përcakton shkallën e ndotjes të enëve dhe vendos automatikisht temperaturën dhe sasinë e ujit të larjes si edhe kohën e larjes. I përshtatshëm për të gjitha llojet e enëve. | I përshtatshëm për enët, tenxheret dhe tiganët shumë të ndotur. | Program special për pastrim me kujdes të qelqurinave delikate. | Program larjeje i përditshëm për enët e ndotura normalisht në mënyrë më të shpejtë. | I përshtatshëm për enët e përditshme të ndotura pak që janë kruajtur ose pastruar paraprakisht. |
| | Mesatare | Mesatare në E lartë | E lartë | E ulët | Mesatare | E ulët |
| Prewash | + | + | + | + | - | - |
| Larje | + | + | + | + | + | + |
| Tharje | + | + | + | + | + | - |
| Kohëzgjatja (min) | 190 | 104-174 | 133 | 132 | 79 | 76 |
| Ujë (l) | 11,5 | 12,2-15,8 | 17,6 | 15,4 | 11,8 | 11,8 |
| Energji (kWh) | 0,849 | 0,90-1,45 | 1,5 | 0,92 | 1 | 0,8 |

**Kapaciteti i ngarkesës:14**

Vlerat e konsumit të treguara në tabelë janë përcaktuar në kushte standarde. Prandaj mund të ketë ndryshime në kushte praktike. * Program referencë për institute testimi. Testet në përputhje me EN 50242/60436 duhet të bëhen me dispenserin e kripës të ujit plot dhe depozitë të solucionit shpëlarës plot, dhe duke përdorur programin e testit. Vlerat e dhëna për programet tjera përveç programës Eco 50C janë vetëm treguese. (#) Funksionet shtesë mund të shkaktojnë ndryshime në kohëzgjatjet e programeve.

# Udhëzim i shpejt

# Rregullimi i sistemit të zbutjes së ujit

Performanca e larjes, shpërlarjes dhe e tharjes së pjatalarëses suaj do të përmirësohet kur sistemi i zbutjes së ujit do të përshtatet siç duhet.
Për ta përshtatur sistemin, së pari mësoni fortësinë e ujit tuaj në rajonin tuaj dhe përshtatni sistemin siç është indikuar më poshtë.

- Shpaketoni shiritin e testit.
- Hapni rubinetin dhe lëreni ujin të rrjedhë për rreth 1 minutë.
- Futeni shiritin e testit në ujë për 1 sekondë.
- Nxirreni shiritin nga uji dhe tundeni.
- Prisni 1 minutë.
- Bëni përshtatjet e nevojshme sipas shiritit testues.




**Pas përcaktimit të fortësisë së ujit:**
1. Kur çelësi i zgjedhjes së programit është “Fikur”, mbani të shtypur butonin Nis / Pauzë / Anulo dhe rrotullojeni çelësin e zgjedhjes së programit me një hap në drejtimin orar dhe mbani të shtypur butonin Nis / Pauzë / Anulo për 3 sekonda; pajisja do të kalojë te modaliteti i përcaktimit të rigjenerimit pas kësaj periudhe.
2. Niveli i rigjenerimit në memorie ndriçohet për 5 sekonda kur hyni në modalitetin e përcaktimit të rigjenerimit.
3. Për caktimin e një niveli të ri të fortësisë së ujit, vendoseni Çelësin e Zgjedhjes së Programit te pozicioni i duhur për nivelin e fortësisë së ujit të rrjetit tuaj kryesor. (Shikoni Tabelën e përcaktimit të nivelit të fortësisë së ujit)
4. Shtypni butonin Nis / Pauzë / Anulo për të regjistruar përcaktimin e zgjedhur në memorie.
5. Kalojeni çelësin e zgjedhjes së programit te pozicioni "Fikur".



## Tabela e përcaktimit të nivelit të fortësisë së ujit

| Niveli i fortësisë | Fortësia angleze °dE | Fortësia gjermane °dH | Fortësia franceze °dF | Çelësi i zgjedhjes së nivelit të programit * | Treguesi i nivelit të fortësisë së ujit |
|---|---|---|---|---|---|
| 0. Niveli | 0-5 | 0-4 | 0-8 | 1 | Në panel ndriçon drita e larjes. |
| 1. Niveli | 6-9 | 5-7 | 9-13 | 1 | |
| 2. Niveli | 10-15 | 8-12 | 14-22 | 2 | Në panel ndizet drita e tharjes. |
| 3. Niveli | 16-19 | 13-15 | 23-27 | 3 | Në panel ndizet drita e përfundimit. |
| 4. Niveli | 20-24 | 16-19 | 28-34 | 4 | Në panel ndizen dritat e larjes, tharjes dhe përfundimit. |
| 5. Niveli | 25-62 | 20-50 | 35-90 | 5 | Dritat e larjes, tharjes dhe përfundimit në panel pulsojnë me intervale prej 1 sekonde. |

Bëni të njëjtin rregullim të nivelit të fortësisë që keni bërë në panelin e kontrollit me çelësin e rregullimit të rigjenerimit. Për shembull, nëse e keni rregulluar në "3" në panelin e kontrollit, vendoseni edhe çelësin e rregullimit të rigjenerimit në 3.

| Çelësi i Rregullimit të Rigjenerimit | Niveli 0 | Niveli 1 | Niveli 2 | Niveli 3 | Niveli 4 | Niveli 5 |
|---|---|---|---|---|---|---|
|  | 1 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |





- Nëse niveli i fortësisë së ujit që përdorni është mbi 50°dH  ose nëse përdorni ujë nga pusi, atëherë rekomandohet të përdorni filtër dhe pajisje për pastrimin e ujit.
- Nëse niveli i fortësisë së ujit që përdorni është nën 7°dH (standardi francez për fortësinë e ujit), nuk ka nevojë të përdorni kripë në pjatalarëse. Në këtë rast, Indikatori i Kripës në panelin e kontrollit të pjatalarëses suaj do të ndriçoj vazhdimisht.
- Nëse fortësia e ujit është vendosur në nivelin 1, Indikatori Kripës do të qëndrojë ndezur megjithëse nuk është e nevojshme të përdorni kripë. Nëse përdorni kripë në këtë situatë, kripa nuk do të konsumohet dhe llamba nuk do të ndizet.

Kur zhvendoset, do të duhet të përcaktoni nivelin e fortësisë së ujit të pjatalarëses suaj sërish sipas të dhënave më lartë, varësisht nga fortësia e ujit të vendit ku e keni vendosur.Nëse niveli i fortësisë të ujit të pajisjes tuaj është rregulluar më parë, pajisja do të tregojë rregullimin më të fundit të nivelit të fortësisë.